

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mybera Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit T.Th, nga P, rr.“A R” nr..., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.173/16 të dt.21.10.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.09.12.2016, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ibrahim Berisha dhe i akuzuari, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari T.Th**, i biri i H dhe E, e gjinisë L, i lindur më *data e lindjes*, në K, tani me vendbanim në P rr.“A R”,nr..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar studimet në farmaci, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numri personal* nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse

Nga data e pacaktuar e deri me dt.23.02.2016, rreth orës 17:00 i akuzuari T.Th ka poseduar pa autorizim revolen e tipit “Zastava 99” me nr.serik 53388, dhe një karikator me 11 fishekë të kalibrit 9x19mm, gjatë një kontrolli rutinor, nga ana e pjesëtarëve të PK-së, në P rr.“A K”, në çajtoren “Beni” i është gjetur revolja në brez e cila është sekuestruar nga ana e policisë.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 46, 47, 73, 74 dhe 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 të KPPRK, e:

### G J Y K O N

**ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 400 (katërqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t’*a* paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke iu llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që t’*i* paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 30 (tridhjetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet revolva e tipit “Zastava 99” me nr.serik 53388, dhe një karikator me 11 fishekë të kalibrit 9x19mm, mjet ky me të cilën është kryer vepra penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë, PP/I.nr.173/2016 të dt.21.10.2016 kundër të akuzuarit T.Th, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, më datë 09.12.2016, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pas konsultimit paraprak dhe të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të kryerjes së veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit T.Th, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merr si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari T.Th në fund ka deklaruar: njëherit i premton gjykatës se në të ardhmen asnjëherë nuk do të përsërisë këto veprime, ndihet i penduar për kryerjen e veprës penale dhe gjithashtu kërkon nga gjykata që pranimin e fajësisë shumë të sinqertë të cilën e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale ta vlerësojë si një rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të çfarëdo lloji të sanksionit penal.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë

në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e armës është marrë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.605/16, dt.09.12.2016**

**Procesmbajtësja**  
Mybera Latifi

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.